



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.99/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.99/2021 të datës 24.02.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati "Veriq", Komuna e Istogut, kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore-ndërprenje e marrëdhënies së punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.99/2021 e datës 24.02.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 22.01.2021 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 24.02.2021 dhe është protokolluar më Nr. Port: 814/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.03.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 03.03.2021 ka dërguar provat e kërkuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 814/2021 e datës 24.02.2021 e parashtruar nga ankuesi në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarfin e datës 22.02.2021; Kontratën e Punës së Ankuesit e datës 17.08.2015; Përshkrimi i detyrave të punës së ankuesit; Vendimin me Nr. 226/20 i datës 04.11.2020 për themelimin e Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektuese Dubravë; Vendimin e datës 14.11.2019 për caktimin e si zëvendësues i Drejtorit të Qendrës Korrektuese Dubravë; Akt Emërimit e Diplomën e Kolegjit Juridica për Kontratën e Punës së Certifikatën e Kolegjit Biznesi për Akt Emërimit e Certifikatën e Fakultetit Juridik për Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore e datës 18.12.2020 për ankuesin nga Vendim i datës 15.12.2020 i Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektuese në Dubrave; Procesverbal i datës 26.01.2021 i Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektuese në Dubravë; Thirrje për intervistë e datës 20.01.2021; Vendim i datës 27.01.2021 i Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektuese në Dubravë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankuesit dhe Përgjigje në ankesë e datës 03.03.2021 nga SHKK.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, konstaton se në bazë të Kontratës së Punës të datës 17.08.2015 ankuesi mban pozitën "Pastrues" në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës e cila është lidhur mbi bazën e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë janë ndarë në: nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës, në kuadër të kësaj pozita "Pastrues", si pozitë që kryen veprimtari të mirëmbajtjes hyn në kuadër të zyrtarëve publik si nëpunësi administrativ dhe mbështetës siç parashihet me paragrafin 6 të nenit 2 të këtij ligji, i cili përcakton që: "Nëpunësi administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ugjashme në institucionet e administratës publike", kështu që meqenëse pozita që mban ankuesi "Pastrues" nuk është pozitë e nivelit profesional por është pozitë e nivelit tekniko-administrative, atëherë sipas vlerësimit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në rastin konkret respektivisht për pozitat tekniko-administrative nuk mund të aplikohet neni 4 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë".

Ndërlidhur me këtë pjesa VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësit administrativ dhe mbështetës, ku neni 82 i këtij ligji, përcakton se: "Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës", mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është

kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, mbi bazë të lartcekurave, dhe duke ju referuar nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, përcakton se: *"Komisioni i themeluar sipas nenit 11 të kësaj Rregullore është kompetent edhe për procedurën disiplinore të nëpunësve mbështetës administrativ të punësuar në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet tjera shtetërore"*, konstaton se komisioni disiplinor i themeluar sipas kësaj rregulloreje shqyrton rastet e nëpunësve mbështetës dhe administrativ, por meqenëse këta zyrtar nuk janë nëpunës civil atëherë edhe këshilla juridike për përdorimin e mjeteve tjera të ankimit duhet të përshkruhet konform nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe në pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"*, në rastin konkret Komisioni Disiplinor i Qendrës Korrektuese në Dubravë në Vendimin e datës 27.01.2021, është dashur që të veproj konform nenit të lartcekur.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.99/2021

Avdyll BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

